



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2024:085694

Datë: 19.12.2024

Numri i dokumentit: 06623951

C.nr.3621/2024

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS – Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, duke shqyrtuar dhe zgjidhur kontestin nga marrëdhënia juridike civile sipas padisë së paditësit N. B., nga Prishtina, rruga N. P., Mati I. B-..., përfaqësuar me autorizim nga B. B., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Qeveria e Kosovës – Ministria e Kulturës, Rinis dhe Sportit, me seli në Prishtinë, përfaqësuar në shqyrtimin kryesor nga N. A., avokate shtetërore, sipas autorizimit, me objekt të kontestit vërtetimin e diskriminimit në pagë, dhe pagesën e diferencës në pagë, vërtetimi i cenimit të dinjitetit dhe dëmshpërblimi në emër të tij, anulimin e kontratës së punës dhe kompensimin e diferencës në pagë, me vlerë të objektit të kontestit në shumën prej 57,622.23 (pesëdhjeteshtatë mijë gjashtëqind e njëzet e dy pikë njëzet e tre) € (euro), pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të çështjes të mbajtur më datën 07.10.2024, në seancë publike dhe të drejtpërdrejtë, në të cilën kanë prezantuar të autorizuarit e palëve në kontest, të njëjtën datë dha këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e themeltë ligj kërkesëpadia e paditësit N. B., nga Prishtina dhe DETYROHET e paditura Qeveria e Kosovës – Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me seli në Prishtinë, që paditësit t’ia paguaj diferencën e ndryshimit në pagë për periudhën kohore nga data 01.07.2011 deri më 30.04.2014, në shumën neto prej 4,780.43€, diferencën e kontributit pensional në Fondin e Trustit Pensional të hapur në emër të paditësit në shumën prej 508.03€, diferencën e tatimit në pagë që duhet paguar në dobi të buxhetit të Kosovës në shumën prej 45.85€, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

II. DETYROHET e paditura Qeveria e Kosovës – Ministria e Kulturës, Rinis dhe Sportit, me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të kamatës ligjore për periudhën deri më 31.08.2024, t’ia paguaj shumën prej 2,204.61€, kurse prej datës 01.09.2024, kamatën prej 8% në vit, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

III. DETYROHET e paditura që paditëses t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 1,293.60€, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

IV. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit në emër të dëmit jomaterial t’ia paguaj shumën prej 50,000.00€, si e pathemeltë.

A r s y e t i m

Para se të lëshohet në pretendimet e palëve, kjo gjykatë e sheh të arsyeshme të bëjë një përmbledhje të kësaj çështje juridike në aspektin procedural.

Paditësit më datë 09.11.2012, ka parashtruar padi kundër të paditurës.

Më datë 12.02.2015, kjo gjykatë ka mbajtur seancën përgatitore.

Më datë 28.04.2015, kjo gjykatë ka dhënë aktgjykimin C.nr.2906/2012, duke refuzuara kërkesëpadinë e paditësit.

Kundër këtij aktgjykimi ka parashtruar ankesë paditësit më datë 12.05.2015.

Duke vendosur sipas kësaj ankese, Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me aktgjykimin Ac.nr.3544/2015, të datës 15.11.2019, ka vërtetuar aktgjykimin e goditur me ankesë.

Më datë 28.10.2022, paditësi ka parashtruar revizion kundër aktgjyqimeve të cekura më lartë.

Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin Rev.nr.451/2022, të datës 23.11.2022, ka refuzuar revizionin e paditësit.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka marrë aktgjykimin e saj KI 137/23 dt.15 shkurt 2024, me të cilin e ka shpallë të pavlefshëm aktgjykimin Rev.nr.451/2022 dt.23.11.2022 të Gjykatës Supreme të Kosovës, me konstatimin se ka pasur shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar, si një nga komponentët e të drejtës së përgjithshme për një gjykim të drejtë që garanton drejtësi procedurale të mishëruar në paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës, në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, (E drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, përkatësisht, E drejta për një proces të rregullt gjyqësor), me arsyetimin se në rastin konkret nuk është respektuar standardi kushtetues i arsyetimit të vendimit gjyqësor, e që ka të bëjë me çështjet e specifikuara, veç tjerash, si në pikat 60 deri 67 etj, të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese.

Pas kësaj Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin Rev.nr.90/2204, të datës 08.03.2024, ka vendosur pranohet revizioni i paditësit N. B. nga K., prishet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3544/15 datë 15.11.2019 dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2906/12 datë 28.04.2015, ndërsa, lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Paditësi, në këtë gjykatë ka parashtruar padi, së fundi të precizuar në seancën e shqyrtimit kryesor e përmes të autorizuarit të saj me të cilën ka kërkuar që detyrohet e paditura Qeveria e Kosovës – Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me seli në Prishtinë, që paditësit t’ia paguaj diferencën e ndryshimit në pagë për periudhën kohore nga data 01.07.2011 deri më 30.04.2014, në shumën neto prej 4,780.43€, diferencën e kontributit pensional në Fondin e Trustit Pensional të hapur në emër të paditësit në shumën prej 508.03€, diferencën e tatimit në pagë që duhet paguar në dobi të buxhetit të Kosovës në shumën prej 45.85€, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Detyrohet e paditura Qeveria e Kosovës – Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me seli në Prishtinë,

që paditësit në emër të kamatës ligjore për periudhën deri më 31.08.2024, t'ia paguaj shumën prej 2,204.61€, kurse prej datës 01.09.2024, kamatën prej 8% në vit, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura përmes të autorizuarës së saj, me përgjigje në padi, seancat e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke i propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave: Vendimit të KPMK-së Nr. reference A02/281/2012, datë 12.10.2012; Ankesës Nr. protokoll 1717/2012, drejtuar në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS) datë 03.08.2012; Përgjigjes në ankesë nga TEIP, datë 05.03.2012; Kërkesës së datës 03.07.2012 Nr.prot 245, me listën e punëtorëve të cilët i kanë plotësuar tre vite punë të pandërprerë; Ankesës së datës 15.02.2012, Nr. protokoll 390/2012, drejtuar MKRS; Kërkesës së dërguar nga Drejtoresha e TKK-së, datë 24.10.2011 për Sekretarin e përgjithshëm të MKRS; Kërkesës për MKRS Nr.prot. 1510/2012, date 06.07.2012; Ankesës drejtuar MKRS Nr. prot.2116/1/2012, datë 26.09.2012; Ankesës datë 21.02.2012; Ankesës datë, 29.12.2012; Listës së pagave për periudhën kohore 01.07.2012, deri më 31.07.2012;; 01.10.2012, deri më 31.10.2012; Kërkesës me nr.prot.308, datë 12.10.2012; Marrëveshjes për shërbime të veçantë, datë 30.10.2012; Vendimit të Sekretarit të përgjithshëm të MKRS, datë 29.05.2012, Nr. 782/2012; Marrëveshjes - Kontratës Nr. 23/2012, datë 01.06.2012; Kontratës për periudhën kohore nga 01.02.2012, deri më 01.04.2012; Kontratës së protokolluar më datë 23.01.2012; Kontrata së protokolluar më datë 06.01.2011; Kontratës datë 01.01.2010, 14.07.2009; Kërkesës me nr. prot 262, datë 01.07.2009; Kontratës për periudhën kohore 01.07.2009 deri më 31.03.2015; Kontratës në emër të aktorit Shpejtim Kastrati 28/2014 dhe 26/2014, për periudhën kohore 01.01.2014, deri më 31.03.2014 respektivisht, nga data 31.10.2014, deri me 31.12.2014, Kërkesës së paditësit drejtuar në

MKRS me nr. prot 3207/2013, datë 19.08.2013; Ankesës së adresuar nga paditësi për MKRS me Nr. Protokoli 4071/2013, datë 21.10.2013; ankesës së paditësit me Nr. Protokoli, 1857/2014, datë 05.05.2014; Ankesa e paditësit drejtuar MKRS datë 06.02.2014 dhe Raportit të Auditorit për gjetjet, (raport pa datë dhe pa numër protokoli), ekspertizën financiare dhe plotësimin e saj.

Gjykata pasi që bëri administrimin dhe vlerësimin e provave me ndërgjegje dhe me kujdes ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku dhe në bazë të rezultatit të gjithë procedimi, referuar nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore vendosi që kërkesëpadinë e paditëses ta aprovon si të themeltë në prova dhe ligj.

Përgjatë rrjedhës së procedurës në këtë çështje juridike, ndërmjet palëve nuk ishte kontestuese fakti se paditësi sipas kontratës së punës është e punësuar tek e paditura.

Kontestuese ishte çështja se paditësi për periudhën kontestuese a është dashur të paguhet sikurse kolegët e tij që kanë qenë me kontratë të rregullte punës.

Nga provat e administruara gjykata gjeti se paditësi nga muaji korrik i vitit 2009 dhe në vitet pasuese (deri në vitin 2014) me të paditurën ka lidhur kontrata mbi vepër, me të cilat kontrata është angazhuar në detyrën aktor në TKK. Pas miratimit të Rregullores 05/2011 për pagat dhe gradimin e krijuesve, performuesve dhe punonjësve profesional të trashëgimisë kulturore, për legalizimin e vendit të punës, në vazhdimësi ka parashtruar kërkesa/ankesa te e paditura. Kërkesa për legalizim të vendeve të punës, të paditurës i janë parashtruar edhe nga ana institucionit përkatësisht, nga TKK. Për shkak se e paditura nuk ka vendosur për legalizimin e vendit të punës, pas shterjes së mjeteve të brendshme juridike, paditësi i është drejtuar me ankesë KPMK dhe pasi KPMK është shpallur jo kompetent për të vendosur në çështjen e parashtruar, brenda afatit ligjor ka kërkuar mbrojtjen gjyqësore të të drejtave nga marrëdhënia e punës.

Kjo gjykatë vlerëson se, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, bazuar në provat e administruara, dhe mbi gjendjen faktike të vërtetuar si më lartë, kërkesëpadia e paditësit është e themeltë në prova dhe ligj, për arsye se:

Me nenin 1, par. 3 të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është përcaktuar se ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës, e posaçërisht që kanë të bëjnë me, ndër të tjera edhe kushtet e punësimit dhe të punës, përfshirë shkarkimin apo ndërprerjen e kontratës dhe pagesës.

Me nenin 3 par. 1 të po të njëjtit ligj është përcaktuar se parimi i trajtimit të barabartë nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë sipas kuptimit të cilitdo nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji. Ndërsa në par. 2 të po të njëjtit nen është përcaktuar se diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvleftësoj ose cenoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Me nenin 4 par. 1 të po të njëjtit ligj është përcaktuar se diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.

Me nenin 8 të po të njëjtit ligj është përcaktuar se të gjitha institucionet duhet të veprojnë në përputhje me parimet e këtij Ligji, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre dhe gjatë hartimit të politikave dhe legjislacionit.

Me nenin 20 par. 2 të po të njëjtit ligj përcaktohet se barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, kjo gjykatë erdhi në përfundim se e paditura me veprimin e mos pagesës njëjtë për paditësin ka shkelur të drejtat e tij që ka të

bëjë me kushtet e punësimit dhe pagesës, duke bërë diskriminimin e drejtpërdrejtë të paditësit duke e trajtuar në mënyrë më pak të favorshme.

Krahas kësaj, kjo gjykatë vlerëson se e paditura me asnjë provë nuk ka dëshmuar se me rastin e pagesës së paditësit më pak se sa kolegët e tij, nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë të paditësve, e në anën tjetër gjykatës i ka munguar autorizimi që të nxjerr prova sipas detyrës zyrtare sepse me nenin 7 paragraf 2 të LPK-së, përcaktohet se: “ Gjykata është e autorizuar ti vërtetoj edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur si dhe ti marrë edhe provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuara në nenin 3 paragraf 3 të këtij ligji) në qoftë se me ligj nuk është përcaktuar ndryshe ”.

Përfundimisht, gjykata vlerëson se e paditura me rastin e mos pagesës njëjtë paditësit sikurse kolegët e tij për punën e njëjtë, ka bërë diskriminim të drejtpërdrejtë ndaj tij duke e trajtuar në mënyrë më pak të favorshme sesa janë trajtuar të punësuarit e tjerë në pozitat e përmendura.

Meqenëse gjykata gjeti se e paditura me veprimet e saj ka bërë diskriminim të drejtpërdrejtë ndaj paditësit, vendosi që të detyroi të paditurën që paditëses t’ia kompensoj shumat si pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për arsye se:

Me nenin 16 par. 2 të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është përcaktuar se gjykata pasi që merr provat dhe argumentet relevante vërteton se i padituri ka kryer veprime apo mosveprimeve diskriminuese ndaj paditësit mund të vendos që: ndër të tjerë edhe të kompensojë dëmin material ose jomaterial të shkaktuara nga shkelja e të drejtave të mbrojtura me këtë Ligj, sipas padisë për dëmshpërblim.

Me par. 5 të po të njëjtit nen është përcaktuar se Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e dëmshpërblimit zbaton ligjin përkatës për marrëdhëniet detyrimore.

Me nenin 136 par. 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve është përcaktuar se kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.

Me neni 137 të po të njëjtit ligj është përcaktuar se dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material).

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore dhe meqenëse gjykata me provat dhe argumentet relevante ka vërtetuar se e paditura ka kryer veprime diskriminuese ndaj paditësve, atëherë bazuar në këto dispozita ligjore ka detyruar që paditurën që t'ua kompenzon paditësve shumat si në pikën II të diapozitivit të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë vlerëson se për të ekzistuar detyrimi për shpërblimin e dëmit, duhet të plotësuar këto parakushte: 1. Të ekzistojnë subjektet e marrëdhënies detyrimore dhe të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar shkaktuesi i dëmit dhe i dëmtuari; 2. të ekzistojë fakti dëmtues, nga rrjedh dëmi; 3. Të ekzistojë dëmi i shkaktuar; 4. të ekzistojë lidhja shkakësore ndërmjet faktit dëmtues dhe dëmit të shkaktuar; 5. të ekzistojë kundërligjshmëria e veprimit, përkatësisht e mosveprimit nga është shkaktuar dëmi. Në rastin konkret janë plotësuar këto kushte për shpërblimin e dëmit e kjo për faktin se dihet kush është shkaktari i dëmi, pra këtu e paditura, dihet fakti dëmtues e që është veprimi diskriminues i të paditurës, ekziston dëmi pasi që paditësit janë privuar nga rritja e pagës, dhe ekziston lidhja shkakësore ndërmjet faktit dëmtues, pra veprimit diskriminues dhe dëmit të shkaktuar – mos përfshirjes së paditësve në vendimin për rritjen e pagave.

Për të përcaktuar lartësinë e diferencës së pagave ta papaguara, trustit, dhe kontributeve pensionale, sipas propozimit të palës paditëse gjykata ka bërë nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare të punuar nga eksperti financiar A. B.

Nga administrimi i ekspertizës në cilësinë e provës materiale gjykata ka gjetur se diferenca për shkak të diskriminimit në pagë paditësit për periudhën 01.07.2011 deri më

30.04.2015, arrin vlerën bruto 5,080.60€, ashtu që paga neto është 4,780.43€, kamata 2,204.61€, kontributi pensional 508.03€, kurse tatimi në pagë 45.85€.

Kësaj ekspertize gjykata ia fali besimin pasi që e njëjta ka qenë e përpiluar në mënyrë profesionale dhe sipas mënyrës dhe metodologjisë së shkencës adekuate.

Për efekt të natyrës së kësaj çështje juridike, kjo gjykatë vlerëson se ky aktgjykim është në pajtim me instrumentet ndërkombëtare që garantojnë të drejtat dhe liritë e njeriut e që janë të zbatueshme edhe në Republikën e Kosovës, bazuar në nenin 22 të Kushtetutës. Kështu, me nenin 14 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin në vijim do të përdoret vetëm emri: Konventa), është përcaktuar se gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Gjykata vendosi si në pikën IV të këtij aktgjykimi, për faktin se i njëjti mund të ketë pësuar dhimbje shpirtërore për shkak të diskriminimit në pagesë nga marrëdhënia e punës, dhe kjo jo domosdoshmërisht përbën shkak që ai të ketë të drejtën e kompensimit për këtë kategori të dëmit.

Gjykata e detyroi palën e paditur që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë për përpilimin e parashtrësës për precizimin e kërkesëpadisë 208 euro, për pagesën e taksës për padi 75 euro, për përfaqësim në 3 seanca shumë prej 810.60€, për ekspertizën financiare 200 euro, gjithsejtë 1,293.60 euro. Gjykata vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e ka bazuar në nenin 452.1,453 dhe 449 të LPK-së.

Kjo gjykatë, me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas kundërshtimeve të palës së paditur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 143 dhe nenin 160 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.3621/2024, më 07.10.2024.

GJYQTARI

PËRPARIM ZEKA

UDHËZIMI MBI TË DREJTËN E ANKESËS:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimi të së njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palën kundërshtare.